



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 50, datë 03.06.2022

PËR
AKREDITIMIN E PARË TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
BACHELOR NË "BIOLOGJI", TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike", Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë", i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 11.9.2018, "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr.1, datë 07.04.2017, "Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë", Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, "Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit" dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 "Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit", në mbledhjen e tij të datës 03.06.2022, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Biologji", me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Bachelor në "Biologji"
- b) Cikli i studimit: Cikli i parë
- c) Akti zyrtar i hapjes/ licensimit: Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 124, datë 17.02.2010
- d) Institucioni që e ofron: Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë
- e) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Biologjisë
- f) Kohëzgjatja (Vite/ semestra): 3 vite / 6 semestra
- g) Kredite (ECTS): 180 kredite
- h) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- i) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë
- j) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 6

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Raportimin e Ekspertëve të Vlerësimit në mbledhjen e Bordit;
- e. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- f. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- g. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimit gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuar e verifikuar përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësimin të *“Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”* dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit është **“i përmbush kryesisht standardet”**, me mangësitë si më poshtë:
 1. Ngarkesa mësimore e lartë e shprehur në orë e në numër lëndësh, për një pjesë të personelit akademik, të këtij programi studimi.
 2. Disa nga anëtarët e personelit akademik të këtij programi studimi, nuk zotërojnë kualifikimin e nevojshëm për tu angazhuar si lektor në këtë program studimi.
 3. Fusha e ekspertizës e disa prej anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, nuk është në përputhje me lëndët që ata mbulojnë
 4. Mungesa e një studimi të mirëfilltë të tregut të punës për të njohur nevojat reale të tregut rajonal e kombëtar për këtë program studimi.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,

VENDOSI:

1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit **Bachelor** në **“Biologji”**, të **Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë**, me rekomandimet sipas shtojcës së këtij vendimi.
2. **Akreditimin** e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **4 (katër)** vite.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **02/06/2026**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së

këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT

| | | |
|----------------------|--|----------|
| SHQIPONJA TELHAJ |  | Kryetare |
| ALEXANDER KOHLER |  | Anëtar |
| AYŞEN SAVAŞ SARGIN |  | Anëtar |
| TOMASZ JELENSKI |  | Anëtar |
| IRAJ HASHI |  | Anëtar |
| MAURICE OUDEJANS |  | Anëtar |
| LEA YPI |  | Anëtar |
| KITA SALLABANDA DIAZ |  | Anëtar |
| DARINKA PIQANI |  | Anëtar |
| DRITAN NAÇE |  | Anëtar |

INDRIT HOXHA

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Hoxha', with a horizontal line underneath it.

Anëtar

Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 50, datë 03.06.2022, “Për akreditimin e parë të programit të studimit **Bachelor** në “**Biologji**”, të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, janë si vijon:

1. Institucioni, të rrisë numrin e personelit akademik për këtë program studimi, me qëllim uljen e ngarkesës mësimore të personelit akademik aktual.
2. Institucioni, të marrë masa që i gjithë personeli akademik i angazhuar si lektor në këtë program studimi, të ketë kualifikimin e nevojshëm sipas parashikimeve ligjore e nënligjore në fuqi.
3. Institucioni, të marrë masa që, fusha e ekspertizës e personelit akademik që angazhohet në këtë program studimi, të jetë në përputhje me lëndët që ata mbulojnë.
4. Institucioni, të ndërmarrë një studim të mirëfilltë të tregut të punës me qëllim identifikimin e nevojave reale të tregut rajonal e kombëtar për këtë program studimi.
5. Institucioni, të shohë mundësinë e përshtatjes së këtij programi studimi me programe homologe, me përvojë në vendet e Bashkimit European, si edhe të rishikojë syllabuset e këtij programi studimi, me qëllim përditësimin e tyre me literaturë bazë e ndihmëse, të pesë viteve të fundit.

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë**, duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 6 (gjashtë) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

